



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 07.05.2024)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për pranimin/refuzimin e kërkesës së z. {...} “Për përjashtimin e relatorit dhe të anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, nga procedurat për të cilat ai ka kandiduar për lëvizje paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë” (Çështje që ishte për trajtim në mbledhjen e datës 02.05.2024).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:20 dhe mbaroi në orën 11:23.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------|--------------------------|
| 1. <i>Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 2. <i>Klodian Kurushi*</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 3. <i>Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 4. <i>Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 5. <i>Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 6. <i>Alban Toro*</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 7. <i>Markelian Koça*</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 8. <i>Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 9. <i>Emona Muçi</i> | <i>(anëtare)</i> |

Shënim 1: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Irena Plaku*.

Shënim 2: Për shkak të objektivit të kërkesës/çështjes së parë të rendit të ditës, në trajtimin e kësaj çështjeje nuk duhet të marrin pjesë *z. Kurushi, z. Koça dhe z. Toro*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
2. *Dorina Priifti, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
3. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
4. *Valbona Bala, eksperte pranë EWMI/INL.*
5. *Arben Lila, përfaqësues i EU4Justice.*
6. *Sidorela Driçi, Instituti Shqiptar i Shkencës.*
7. *Edmon Hoxhaj, Birn.*
8. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për pranimin/refuzimin e kërkesës së z. {...} “Për përjashtimin e relatorit dhe të anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, nga procedurat për të cilat ai ka kandiduar për lëvizje paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë” (Çështje që ishte për trajtim në mbledhjen e datës 02.05.2024).

Ilir Rusi: Përshëndetje anëtarët të Këshillit të Lartë Gjyqësor!

Ju uroj javë të mbarë!

Ju bëj me dije që Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Llagami*, për arsye objektive nuk mund të jetë prezent në këtë mbledhje.

Gjithashtu edhe *znj. Plaku* për arsye të përjashtimit të pjesëmarrjes së saj në këto dy çështje, nuk është prezent në këtë mbledhje.

Për shkak të krijimit të kuorumit të nevojshëm mbledhjen e deklaroj të hapur, të ditës së sotme datë 07.05.2024, ora 11:00.

Në lidhje me pikën e parë të saj që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për pranimin/refuzimin e kërkesës së z. {...} “Për përjashtimin e relatorit dhe të anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, nga procedurat për të cilat ai ka kandiduar për lëvizje paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë”, çështje që ishte për trajtim në mbledhjen e datës 02.05.2024.

Meqenëse prezent në mbledhje dhe objekti i kësaj kërkesë është përjashtimi i z. Kurushi, z. Toro dhe z. Koça, dhe në mungesë të tyre për të marrë pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje, kemi mungesë kuorumi për t’u trajtuar kjo çështje, sepse prezent në mbledhje është znj. Muçaj, znj. Rupa, znj. Luli, z. Hado, znj. Muçi dhe z. Rusi. Pra jemi 6 anëtarë dhe nuk mund të vazhdojmë me shqyrtimin e kësaj pike të këtij rendi dite.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 07.05.2024)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për pranimin/refuzimin e kërkesës së gjyqtarit z. {...} “Për përjashtimin e relatores znj. Irena Plaku nga procedura e vlerësimit etik dhe profesional, për periudhën 2017-2019”” (Çështje që ishte për trajtim në mbledhjen e datës 02.05.2024).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:20 dhe mbaroi në orën 11:23.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Alban Toro | (anëtar) |
| 7. Markelian Koça | (anëtar) |
| 8. Yllka Rupa | (anëtare) |
| 9. Emona Muçi | (anëtare) |

Shënim 1: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Irena Plaku*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 2. Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 3. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
- 4. Valbona Bala, eksperte pranë EWWMI/INL.*
- 5. Arben Lila, përfaqësues i EU4Justice.*
- 6. Sidorela Driçi, Instituti Shqiptar i Shkencës.*
- 7. Edmon Hoxhaj, Birn.*
- 8. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për pranimin/refuzimin e kërkesës së gjyqtarit z. {...} “Për përjashtimin e relatores znj. Irena Plaku nga procedura e vlerësimit etik dhe profesional, për periudhën 2017-2019”” (Çështje që ishte për trajtim në mbledhjen e datës 02.05.2024).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 2 të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për pranimin/refuzimin e kërkesës së gjyqtarit z. {...} “Për përjashtimin e relatores znj. Irena Plaku nga procedura e vlerësimit etik dhe profesional, për periudhën 2017-2019””, çështje që ishte për trajtim në mbledhjen e datës 02.05.2024.

Keni ndonjë diskutim?

Atëherë, në shqyrtimin e kësaj çështjeje z. Kurushi, z. Koça dhe z. Toro janë prezent, kështu që jemi 9 anëtarë për shqyrtimin e kësaj çështjeje.

Po zoti Kurushi, fjala për ju.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Rusi!

Unë do propozoja që edhe kjo pikë e rendit të ditës të shtyhej për mbledhjen më të afërt që do të organizohet nga Këshilli, për shkak se mendoj që meqenëse kërkesat kanë të njëjtin objekt, pra kanë objekt të ngjashëm, janë të natyrave të ngjashme në lidhje me objektin e kërimit që kanë paraqitur të dy magjistratët. Kështu që duke qenë se kanë ngjashmëri për shkak të natyrës dhe kërkesave specifike që kanë paraqitur magjistratët propozoj që edhe kjo pikë e rendit të ditës të shtyhej dhe të trajtohej në të njëjtën ditë që do trajtohet edhe pika e parë e rendit të ditës së sotme. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime të tjera?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë në votimin e propozimit të z. Kurushi.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Atëherë, në lidhje me këtë vendimmarrje, edhe pika 2 e këtij rendi dite shtyhet për t'u shqyrtuar në një mbledhje të ardhshme të shpejtë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ditë të mbarë dhe javë të mbarë!

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor